



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 10.6.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË (HUAMARRËSI), OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE), SH.A., (AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT) DHE KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR PROGRAMIN E INVESTIMEVE PËR SHPËRNDARJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE I”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a., (agjencia zbatuese e projektit) dhe KfW, frankfurt am main (KfW), për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”, në mbledhjen e tij të datës 10 qershor 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zonjën Eglantina GJERMENI.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe të OSHEE sh.a.-së.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2016 për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Projektligji synon synon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a. (agjencia e zbatuese e projektit) dhe KfW, Frankfurt am Main (KfW), për financimin e programit të investimeve në shpërndarjen e energjisë elektrike I.

Në mars 2019 kaloi marrëveshja e bashkëpunimit e cila i paraprin ratifikimit të marrëveshjes financiare sipas së cilës Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin nga KfW për projektin "Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I" shumat e mëposhtme:

- Një kredi të butë të KfW-së, e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim, në vlerë 30 000 000 euro nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur. Ky projekt nuk mund të zëvendësohet nga projekte të tjera.
- Një shumë financimi prej gjithsej 2 000 000 euro për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit.

Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I do të ndikojë në:

- përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike,
- reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe
- rritjen e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike për klientët.

Gjithashtu, ky program do të mbështesë dixhitalizimin e menaxhimit të rrjetit të OSHEE-së duke zgjeruar dhe përmirësuar qendrën e kontrollit të shpërndarjes me një sistem të fjalës së fundit IT për Sistemin e Kontrollit dhe Menaxhimit të të Dhënave (SCADA) etj.

Huaja që do të akordohet nëpërmjet marrëveshjes në fjalë, do t'i nënhuazohet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike me të njëjtat terma dhe kushte financiare si huaja e akorduar nga KfW-ja, me anë të kësaj marrëveshjeje.

Huaja ka termat e mëposhtën financiarë:

- Shuma e financimit: 30 000 000 euro;
- Interesi: normë fikse vjetore, e cila do të përcaktohet një ditë pas njoftimit ndaj KfW-së se marrëveshja është bërë efektive;
- Tarifa e angazhimit: 0.25% vjetor mbi shumën e padisbursuar të kredisë. Kjo tarifë do të fillojë të aplikohet 12 muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes;
- Tarifa e menaxhimit: 1% mbi shumën e kredisë;
- Maturimi: 12 vjet, duke përfshirë periudhën prej 4 vjetësh pa pagesë principali.

Norma e interesit të huas nuk përcaktohet në marrëveshje, por është dakordësuar në marrëveshje se kjo normë do të përcaktohet nga KfW-ja dy ditë pune nga marrja e njoftimit nga ana e Shqipërisë se janë përmblusur kushtet e bërjes efektive të marrëveshjes së huas. Ky është një kusht i vendosur nga KfW-

ja, pasi, derisa kredia të bëhet efektive dhe të konsiderohet kredi e angazhuar për vendin tonë, nuk ka një bazë ligjore për KfW-në për të përcaktuar normën e interesit. Sidoqoftë bazuar në trendin e mëparshëm të huave të akorduar nga KfW-ja, pritet që norma e interesit për këtë hua të jetë nën 2%.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, si dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 2 nene.

- ***Diskutimi në komision***

Relatorja e projektligjit u shpreh që realizimi i këtij programi do të ndikojë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rritjen e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike për klientët. Gjithashtu, furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike do të përmirësojë klimën e biznesit dhe kushtet e jetesës në Shqipëri.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë shpjeguan elementët kryesor të kësaj marrëveshjeje duke e konisderuar atë si shumë të rëndësishme për zhvillimin e projekteve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë. Projektet do të jenë kryesisht në nënstacione, fida, etj.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në gjendjen, ecurinë dhe treguesit aktualë të rrjetit të shpërndarjes; termat financiarë të marrëveshjes financiare; parashikimin e përmirësimit të humbjeve në shifra; si dhe projektet konkrete që mund të realizohen me këtë marrëveshje.

- ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi këtë hua për krijimin e mundësive për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, dhe e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm e u shpreh dakord për kalimin e tij për miratim në seancë plenare.

Eglantina GJERMENI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar